



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 191

Tiranë – E premte, 14 tetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 94/2016 datë 29.9.2016	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim..... 21027
Dekret i Presidentit nr. 9763, datë 12.10.2016	Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar bashkie, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë..... 21034
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 6811, datë 13.10.2016	Për delegim kompetence..... 21035



LIGJ
Nr. 94/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË ITALISË PËR
KONVERTIMIN E BORXHIT PËR
ZHVILLIM

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për konvertimin e borxhit për zhvillim, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.9.2016

Shpallur me dekretin nr. 9761, datë 12.10.2016,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani

MARRËVESHJE

MBI PROGRAMIN PËR KONVERTIMIN
E BORXHIT PËR ZHVILLIM NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Qeveria e Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, më poshtë të referuara si “Palët”, me synim nxitjen e bashkëpunimit të tyre dypalësh dhe lehtësimin e barrës së borxhit shqiptar,

duke pasur parasysh se:

Një protokoll dypalësh për bashkëpunimin për zhvillim është nënshkruar nga palët në Tiranë, më 11 dhjetor 2014.

Në kuadër të Protokollit Dypalësh për Bashkëpunimin për Zhvillim 2014–2016 është rënë dakord një tjetër “Program për Konvertimin e Borxhit për Zhvillim” për një shumë totale 20 (njëzet) milionë euro, shtesë ndaj Programit të Parë të Konvertimit të Borxhit për Zhvillim, më poshtë i përmendur si “IADSA I”, tashmë i aktivizuar në kuadër të Protokollit Dypalësh 2010–2012.

Palët kanë rënë dakord se fondet që rezultojnë nga faza e dytë e “Marrëveshjes për Konvertimin e Borxhit për Zhvillim”, referuar më poshtë si “IADSA II”, do të përdoren për të financuar iniciativat e zhvillimit social të promovuara nga institucionet publike shqiptare në nivel kombëtar dhe vendor, në mënyrë që të forcohet kohezioni social mbi baza territoriale, zhvillimi i balancuar rajonal, barazia sociale dhe krijimi i vendeve të punës për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Palët kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

1.1 Kjo Marrëveshje përbëhet nga 7 nene dhe 2 anekse, të cilat formojnë pjesë integrale të saj.

1.2 Kjo marrëveshje lidhet me operacionet e konvertimit të borxhit për zhvillim të borxhit dypalësh të Asistencës Zyrtare për Zhvillim (ODA) për të cilin Republika e Shqipërisë i detyrohet Republikës së Italisë dhe përcakton procedurat për zbatimin e operacioneve të tilla.

1.3 Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj kësteve të huave të renditura në aneksin 1 (Principali dhe interesi), duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Shuma e borxhit, në bazë të operacioneve të konvertimit si më poshtë, nuk do të tejkalojë 20 (njëzet) milionë euro.

1.4 Çdo borxh tjetër aktual dhe i ardhshëm i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ndaj Qeverisë Italiane, mbetet i pacenuar nga kjo Marrëveshjeje.

1.5 Projektet e pranueshme për operacionet e konvertimit do të financohen pjesërisht ose tërësisht nga Qeveria Italiane nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje dhe do të lidhen me projektet e zhvillimit social të rena dakord bashkërisht.



Neni 2

Procedurat e Konvertimit të Borxhit për Zhvillim

2.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shuma përkatëse e papaguar (principali dhe interesi) e huave të renditura në aneksin 1 do të pezullohet deri në një shumë maksimale 20 milionë euro. Në të njëjtën kohë, Qeveria e Republikës së Italisë do t'i komunikojë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, nëpërmjet shkëmbimit të letrave, një plan që përmban listën e detajuar të kësteve (principali dhe interesi) referuar shumës së mësipërme të papaguar që duhet të anulohet.

2.2 Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të depozitojë në Fondin Kundërparti (CPF), që do të hapet në Bankën Qendrore të Shqipërisë në emër të “Marrëveshjes Italo-Shqiptare II të Konvertimit të Borxhit – Komiteti i Menaxhimit”, shumën e parashikuar në nenin 1.3, në 9 (nëntë) këste. Çdo kësht do të konvertohet në lek sipas kursit të këmbimit euro/lek të përcaktuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë në të njëjtën datë të depozitimit të kështit. Kështet do të depozitohen në çdo datë 31 tetor në përputhje me planin e shlyerjes në aneksin 2.

2.3 Ministria e Financave e Shqipërisë, nëpërmjet Ambasadës Italiane do t'i komunikojë Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Drejtorisë së Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim (MAECI-DGCS) dhe Institucionit Financiar Italian (IFI), menaxherit të huave ODA, brenda 15 ditëve nga çdo depozitim, informacionin e mëposhtëm:

- Shumën në lek të depozituar në CPF dhe kursin e këmbimit të përdorur (do të bashkëlidhen dokumentet administrative përkatëse, ku përcaktohet shuma e depozituar);

- Shumën e papaguar në CPF dhe interesin e grumbulluar (nëse ka).

Brenda 15 ditëve nga marrja e informacionit të mësipërm, Institucioni Financiar Italian do t'i japë Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë një njoftim mbi saktësinë e shumës së depozituar në CPF.

2.4 Në fund të periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes, të specifikuar në nenin 7.2, e gjithë shuma e kredituar në Fondin Kundërparti dhe e

disbursuar sipas nenit 3 do të konsiderohet e anuluar.

2.5 Brenda 30 ditësh pune nga dhënia e njoftimit nga Institucioni Financiar Italian, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do t'i paguajë Qeverisë Italiane të gjithë shumën e kredituar në CPF dhe të padisbursuar sipas nenit 3 (e barabartë me shumën e papaguar në CPF) në të njëjtin kurs këmbimi fillestar. Interesi i grumbulluar (nëse ka) dhe/ose interesi i vonuar (nëse ka, i llogaritur pas 30 ditësh pune nga njoftimi prej Institucionit Financiar Italian) do të jetë i pagueshëm.

Neni 3

Përdorimi i fondeve CPF dhe projektet e pranueshme

3.1 Fondet që rezultojnë nga operacionet e konvertimit të borxhit dhe të depozituara në CPF, duke përfshirë interesat e grumbulluara nëse ka, do të përdoren për financimin e projekteve të pranuar bashkërisht të zhvillimit social, asistencës teknike për zbatimin e duhur të programit dhe për personelin dhe funksionimin e Njësisë së Mbështetjes Teknike të referuar në vijim në nenin 4.5.

3.2 Projektet e pranueshme do të promovojnë kohezionin social mbi baza territoriale, zhvillimin e balancuar rajonal, barazinë sociale dhe krijimin e vendeve të punës për të mbështetur Shqipërinë në rrugën e saj të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, siç përmendet në Protokollin Dypalësh Italo-Shqiptar për Bashkëpunimin për Zhvillim, të nënshkruar në Tiranë, më 11 dhjetor 2014.

3.3 Prioritetet do t'u jepet projekteve që investojnë në zhvillimin e burimeve njerëzore, punësimin, promovimin e barazisë gjinore, nxitjen e përfshirjes sociale me vëmendje të veçantë ndaj të rinjve të papunë, grave në nevojë, pakicave e personave me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen e mbrojtjes sociale për grupet e rrezikuara, në një kontekst të verifikueshëm të pjesëmarrjes sociale dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve mjedisore.

3.4 Projektet do të zgjidhen nëpërmjet thirrjes për propozime, të shpallur periodikisht. Institucionet publike shqiptare kanë të drejtë t'i dorëzojnë aplikime Komitetit të Menaxhimit të përmendur në nenin 4 në vijim, me pjesëmarrjen aktive të Rajoneve Italiane dhe autoriteteve



vendore, OJQ-ve italiane dhe atyre shqiptare. Modalitetet e aplikimit dhe ekzekutimit të projektit do të përfshihen në Manualin Operacional të Programit të përmendur në nenin 4.2.

3.5 Projektet e realizuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të paraqiten si të financuara bashkërisht nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane.

3.6 Faturat dhe dokumentet e tjera, që lidhen me projektet, do të ruhen në dosje për pesë vjet pas përfundimit të projektit dhe do të vihen në dispozicion të Qeverisë Italiane sipas kërkesës së tyre. Pala italiane ka të drejtë të vizitojë vendndodhjet e projekteve gjatë dhe pas zbatimit të tyre.

Neni 4

Komiteti i Menaxhimit

4.1 Komiteti i Menaxhimit tashmë i krijuar për zbatimin e IADSA I do të jetë, gjithashtu, përgjegjës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe përbëhet nga:

- në emër të Qeverisë Italiane, Shkëlqesia e Tij, Ambasadori i Republikës Italiane në Republikën e Shqipërisë, ose përfaqësuesi i tij/saj, i asistuar nga anëtarët e Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim;

- në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, ministri i Financave të Republikës së Shqipërisë, ose përfaqësuesi i tij/saj, i asistuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe të Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj pranë Kryeministrisë së Republikës së Shqipërisë.

4.2 Komiteti i Menaxhimit ka detyrat e mëposhtme:

- monitorimin e zbatimit të përgjithshëm të kësaj Marrëveshjeje;

- monitorimin e CPF-së së papaguar, shumat e konvertuara dhe të transferuara në CPF, shumat e fondeve të transferuara dhe që do të transferohen nga CPF te projektet e financuara;

- miratimin e Manualit Operacional të Programit (OMP), me qëllim vendosjen e rregullave dhe procedurave për zgjedhjen dhe financimin e projekteve, monitorimin dhe modalitetet e vlerësimit etj.;

- përzgjedhjen e projekteve që do të financohen në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me rregullat

dhe procedurat e përcaktuara nga OMP-i;

- verifikimin e arritjeve të projekteve dhe monitorimin e zbatimit të projekteve nëpërmjet vizitave në terren dhe vlerësimit të dokumentacionit si Raportet e Progresit dhe ai Përfundimtar, Raportet e Auditimit Financiar, siç do të përcaktohet në kuadër të OMP-së.

4.3 Komiteti i Menaxhimit do t'i sigurojë Palëve raporte vjetore të progresit, duke përfshirë informacione mbi gjendjen e CPF-së dhe mbi të gjitha projektet e financuara që përshkruajnë aktivitetet kryesore të kryera dhe disbursimet përkatëse të kryera.

4.4 Komiteti i Menaxhimit do të mbledhet të paktën çdo gjashtë muaj dhe do të veprojë në përputhje me rregullat dhe procedurat që do të përcaktohen bashkërisht nga Palët.

4.5 Një Njësi e Mbështetjes Teknike (NJMT) është krijuar tashmë në kuadër të IADSA I për të ndihmuar Komitetin e Menaxhimit në kryerjen e detyrave të tij. Termat e referencës dhe përgjegjësitë e NJMT-së janë përcaktuar në kuadër të OMP-së. Njësia përbëhet nga një ekspert italian dhe një ekspert shqiptar, si dhe nga stafi mbështetës. Ekspertët e Njesisë së Mbështetjes Teknike do të veprojnë si Sekretariat i Komitetit të Menaxhimit dhe do t'i raportojnë drejtpërdrejt Komitetit të Menaxhimit. Shpenzimet për personelin, pajisjen dhe funksionimin e NJMT-së do të mbulohen përmes fondeve të CPF-së. Buxheti për asistencë teknike dhe për NJMT-në do të miratohet nga Komiteti i Menaxhimit sipas planeve gjashtëmujore të veprimit dhe planeve financiare të përgatitura nga NJMT-ja. Në lidhje me këtë Marrëveshje, buxheti për NJMT-në nuk do të jetë, në çdo rast, më i madh se 4% i shumës së përgjithshme të parashikuar në nenin 1.3 më sipër, duke përfshirë interesat e grumbulluara nëse ka.

Neni 5

Amendamentet

5.1 Marrëveshja aktuale dhe anekset e saj mund të ndryshohen nëpërmjet shkëmbimit të letrave.

Neni 6

Mosmarrëveshjet

6.1 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në rrugë diplomatike.



Neni 7

Hyrja në fuqi dhe efektiviteti

7.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së të fundit prej dy njoftimeve me anë të të cilave të dyja Palët Kontraktuese do t'i kenë komunikuar zyrtarisht njëra-tjetrës që procedurat e tyre të brendshme përkatëse kanë përfunduar.

7.2 Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në dy vjet pasi kësti i fundit të depozitohet në CPF. Zgjatja e saj mund të bihet dakord reciprokisht, në rast se fondet e dhëna për projekte dhe aktivitete të veçanta nuk janë shpenzuar plotësisht në datën e përfundimit.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit nënshkruer, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze.

Bërë në Tiranë, më 17 qershor 2016, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Për Qeverinë e Republikës së Italisë:

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

AMBASADORI ITALIAN
NË TIRANË
Alberto Cutillo

ANEKSI I

Kredi	Përshkrimi	Nata e nënshkrimit (Huadhënës)	Monedha	Angazhimi fillestar	Shuma e ndryshuar	Data e maturimit
94/006/0	Normalizimi dhe zgjerimi i sistemit të ujit - faza 1	1995-02-21	EUR	6.713.939,69	6.808.760,84	24/02 - 24/08
94/012/0	Realizimi i telekomunikimeve të integruara	1995-02-21	EUR	6.854.602,70		24/02 - 24/08
95/003/0	Financimi i rehabilitimit të hekurudhës Tiranë–Durrës	1995-06-14	EUR	3.098.741,39		17/01 - 17/07
95/006/0	Rehabilitimi i rrjeteve elektrike të Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit	1996-02-19	EUR	4.441.529,33		21/03 - 21/09
95/007/0	Ndërtimi i ujësjellësve të Bovillës për furnizimin me ujë të Tiranës - faza II	1996-03-18	EUR	11.362.051,78		27/05 - 27/11
98/001/0	Financimi i aktivitetit të “prokurimit” për realizimin e programit.	1998-07-06	EUR	11.362.051,78	11.350.864,89	08/01 - 08/07
99/004/0	Rehabilitimi i sistemit të shpërndarjes së ujit në Tiranë	2000-05-11	EUR	27.475.507,03		13/03 - 13/09
99/010/0	Punime infrastrukturore për furnizimin me ujë në Tiranë	2000-05-11	EUR	3.511.906,91		13/03 - 13/09
00/001/0	Mbështetje programi në sektorët e shëndetit, energjisë elektrike, ujit dhe shërbimeve sanitare	2000-05-11	EUR	11.362.051,78		13/03 - 13/09
00/010/0	Ndërtimi i seksionit rrugor Tapizë–Fushë-Krujë dhe urave mbi lumenjtë Drin dhe Mat	2001-02-20	EUR	6.565.775,76	6.563.886,82	30/03- 30/09
02/004/0	Programi i mbështetjes financiare për blerjen e energjisë elektrike nga Italia, adresim i krizës aktuale energjetike në Shqipëri	2002-06-11	EUR	8.505.697,00		12/06 - 12/12
03/006/0	Programi i ristrukturimit teknik dhe menaxherial dhe i forcimit të sistemit të energjisë elektrike KESH në Shqipëri	2003-07-16	EUR	41.528.041,03		07/03 - 07/09
04/006/0	Program për periferitë e Bashkisë së Tiranës Laprakë - Komponenti infrastrukturës	2005-11-23	EUR	3.000.000,00		12/01 - 12/07
04/009/0	Program për ristrukturimin dhe pajisjen e pesë klinikave në	2005-11-23	EUR	5.080.000,00		04/02 - 04/08



	qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë					
04/010/0	Programi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Tiranë	2005-11-23	EUR	6.000.000,00		19/05 - 19/11
04/011/0	Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier dhe mbikëqyrja e punimeve për dy seksionet e afërta Lushnjë-Fier-Vlorë dhe Fier	2004-10-29	EUR	24.350.000,00		24/02 - 24/08
06/002/0	Rehabilitimi i Portit Vlorë	2006-10-04	EUR	15.000.000,00		18/06 - 18/12
06/004/0	Financimi i projekteve në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare nëpërmjet sistemit bankar vendas	2006-02-24	EUR	27.500.000,00		08/04 - 08/10
06/006/0	Programi për rehabilitimin e rrugës Shkodrës - Hani i Hotit	2006-10-04	EUR	21.700.000,00		19/06 - 19/12
06/010/0	Programi për ristrukturimin dhe fuqizimin e sistemit elektrik shqiptar me qëllim integrimin e tij në sistemin e Ballkanit	2006-10-04	EUR	51.494.303,00		16/02 - 16/08
12/002/0	Mbështetje e sektorit shqiptar të bujqësisë nëpërmjet përmirësimit të sektorit të Vajit të Ullirit në Shqipëri	2013-06-19	EUR	3.000.000,00		25/02 - 25/08
12/003/0	Mbështetje e sektorit shqiptar të bujqësisë nëpërmjet fuqizimit të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural	2013-06-19	EUR	5.000.000,00		25/02 - 25/08
12/004/0	Mbështetje e sektorit shqiptar bujqësor nëpërmjet krijimit të një skeme të subvencionuar të sigurimit kundër kushteve të pafavorshme të motit	2013-06-19	EUR	2.000.000,00		25/02 - 25/08

ANEKSI II
SKEDUL PARAPRAK SHLYERJEJE

Kësti i 1-rë – 31 tetor 2016					Kumulative
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali	
03/006/0	EUR	-	2.775,44	12.775,44	18.710,58
04/010/0	EUR	-	588,74	588,74	
04/011/0	EUR	-	469,40	469,40	
99/004/0	EUR	-	4.877,00	4.877,00	
Totali	EUR	-	18.710,58	18.710,58	

Kësti i 2-të – 31 tetor 2017					Kumulative
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali	
03/006/0	EUR	-	12.775,44	12.775,44	37.421,16
04/010/0	EUR	-	588,74	588,74	
04/011/0	EUR	-	469,40	469,40	
99/004/0	EUR	-	4.877,00	4.877,00	
Totali	EUR	-	18.710,58	18.710,58	



Kësti i 3të – 31 tetor 2018				
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali
00/001/0	EUR	-	14.197,69	14.197,69
00/010/0	EUR	-	8.204,86	8.204,86
02/004/0	EUR	-	8.505,70	8.505,70
03/006/0	EUR	-	56.076,84	56.076,84
04/010/0	EUR	-	2.740,17	2.740,17
04/011/0	EUR	-	469,40	469,40
94/006/0	EUR	62.726,51	-	62.726,51
94/012/0	EUR	189.132,22	13.239,27	202.371,49
95/006/0	EUR	123.375,81	9.870,06	133.245,87
95/007/0	EUR	315.612,55	25.249,00	340.861,55
99/004/0	EUR	-	44.210,60	44.210,60
99/010/0	EUR	-	8.778,47	8.778,47
Totali	EUR	690.847,09	191.542,06	882.389,15

919.810,31

Kësti i 4-t – 31 tetor 2019				
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali
00/001/0	EUR	-	28.395,38	28.395,38
00/010/0	EUR	-	16.409,72	16.409,72
02/004/0	EUR	202.516,60	17.011,40	219.528,00
03/006/0	EUR	-	99.378,24	99.378,24
04/006/0	EUR	-	2.062,48	2.062,48
04/009/0	EUR	-	2.362,07	2.362,07
04/010/0	EUR	-	4.891,60	4.891,60
04/011/0	EUR	-	21.770,08	21.770,08
94/006/0	EUR	372.996,64	23.312,32	396.308,96
94/012/0	EUR	378.264,44	23.641,51	401.905,95
95/003/0	EUR	172.152,30	11.620,28	183.772,58
95/006/0	EUR	246.751,62	17.889,50	264.641,12
95/007/0	EUR	631.225,10	45.763,82	676.988,92
98/001/0	EUR	630.603,54	61.483,88	692.087,42
99/004/0	EUR	-	83.544,20	83.544,20
99/010/0	EUR	-	17.556,94	17.556,94
Totali	EUR	2.634.510,24	477.093,42	3.111.603,66

4.031.413,97

Kësti i 5-të – 31 tetor 2020				
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali
00/001/0	EUR	-	28.395,38	28.395,38
00/010/0	EUR	-	16.409,72	16.409,72
02/004/0	EUR	405.033,20	16.403,84	421.437,04
03/006/0	EUR	-	99.378,24	99.378,24
04/006/0	EUR	-	2.062,48	2.062,48
04/009/0	EUR	-	1.739,34	1.739,34
04/010/0	EUR	-	4.891,60	4.891,60
04/011/0	EUR	-	21.770,08	21.770,08
94/006/0	EUR	372.996,64	19.582,33	392.578,97
94/012/0	EUR	378.264,44	19.858,91	398.123,35
95/003/0	EUR	172.152,30	9.898,76	182.051,06
95/006/0	EUR	246.751,62	15.421,98	262.173,60



95/007/0	EUR	631.225,10	39.451,56	670.676,66
98/001/0	EUR	630.603,54	55.177,82	685.781,36
99/004/0	EUR	-	83.544,20	83.544,20
99/010/0	EUR	-	17.556,94	17.556,94
Totali	EUR	2.837.026,84	451.543,18	3.288.570,02

7.319.983,99

Kësti i 6-të – 31 tetor 2021				
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali
00/001/0	EUR	-	28.395,38	28.395,38
00/010/0	EUR	-	16.409,72	16.409,72
02/004/0	EUR	405.033,20	15.593,78	420.626,98
03/006/0	EUR	-	99.378,24	99.378,24
04/006/0	EUR	-	2.062,48	2.062,48
04/009/0	EUR	-	1.739,34	1.739,34
04/010/0	EUR	-	4.891,60	4.891,60
04/011/0	EUR	-	21.770,08	21.770,08
94/006/0	EUR	372.996,64	15.852,39	388.849,03
94/012/0	EUR	378.264,44	16.076,25	394.340,69
95/003/0	EUR	172.152,30	8.177,24	180.329,54
95/006/0	EUR	246.751,62	12.954,46	259.706,08
95/007/0	EUR	631.225,10	33.139,32	664.364,42
98/001/0	EUR	630.603,54	48.871,81	679.475,35
99/004/0	EUR	-	83.544,20	83.544,20
99/010/0	EUR	-	17.556,94	17.556,94
Totali	EUR	2.837.026,84	426.413,23	3.263.440,07

10.583.424,6

Kësti i 7-të dhe – 31 tetor 2022				
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali
00/001/0	EUR	-	28.395,38	28.395,38
00/010/0	EUR	-	16.409,72	16.409,72
02/004/0	EUR	405.033,20	14.783,71	419.816,91
03/006/0	EUR	-	99.378,24	99.378,24
04/006/0	EUR	-	2.062,48	2.062,48
04/009/0	EUR	-	1.739,34	1.739,34
04/010/0	EUR	-	4.891,60	4.891,60
04/011/0	EUR	-	21.770,08	21.770,08
94/006/0	EUR	372.996,64	12.122,39	385.119,03
94/012/0	EUR	378.264,44	12.293,62	390.558,06
95/003/0	EUR	172.152,30	6.455,72	178.608,02
95/006/0	EUR	246.751,62	10.486,94	257.238,56
95/007/0	EUR	631.225,10	26.827,07	658.052,17
98/001/0	EUR	630.603,54	42.565,67	673.169,21
99/004/0	EUR	-	83.544,20	83.544,20
99/010/0	EUR	-	17.556,94	17.556,94
Totali	EUR	2.837.026,84	401.283,10	3.238.309,94

13.821.734,00

Kësti i 8-të – 31 tetor 2023				
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali
00/001/0	EUR	-	28.395,38	28.395,38
00/010/0	EUR	-	16.409,72	16.409,72
02/004/0	EUR	405.033,20	13.973,64	419.006,84



03/006/0	EUR	1.367.308,34	98.024,75	1.465.333,09	
04/006/0	EUR	-	2.062,48	2.062,48	
04/009/0	EUR	-	1.739,34	1.739,34	
04/010/0	EUR	-	4.891,60	4.891,60	
04/011/0	EUR	-	21.770,08	21.770,08	
94/006/0	EUR	372.996,64	8.392,45	381.389,09	
94/012/0	EUR	378.264,44	8.510,98	386.775,42	
95/003/0	EUR	172.152,30	4.734,18	176.886,48	
95/006/0	EUR	246.751,62	8.019,43	254.771,05	
95/007/0	EUR	631.225,10	20.514,82	651.739,92	
98/001/0	EUR	630.603,54	36.259,72	666.863,26	
99/004/0	EUR	-	83.544,20	83.544,20	
99/010/0	EUR	-	17.556,94	17.556,94	
Totali	EUR	4.204.335,18	374.799,71	4.579.134,89	18.400.868,89

Kësti i 9-të – 31 tetor 2024					
1.1.2024 – 7.3.2024					
Kredi	Monedha	Principali	Interesi	Totali	
00/001/0	EUR	-	-	-	
00/010/0	EUR	-	-	-	
02/004/0	EUR	-	-	-	
03/006/0	EUR	551.992,97	46.954,50	598.947,47	Sa i përket maturimit 7.3.2024:
04/006/0	EUR	-	1.031,24	1.031,24	690.506,94 46.954,50 737.461,44 shuma fillestare e pagueshme
04/009/0	EUR	-	869,67	869,67	138.513,97 - 138.513,97 për t'u paguar 7.3.2024
04/010/0	EUR	-	-	-	551.992,97 46.954,50 598.947,47 për konvertim
04/011/0	EUR	518.335,01	10.885,04	529.220,05	
94/006/0	EUR	186.498,32	2.797,48	189.295,80	
94/012/0	EUR	189.132,22	2.836,99	191.969,21	
95/003/0	EUR	86.076,15	1.721,52	87.797,67	
95/006/0	EUR	-	-	-	
95/007/0	EUR	-	-	-	
98/001/0	EUR	-	-	-	
99/004/0	EUR	-	-	-	
99/010/0	EUR	-	-	-	
Totali	EUR	1.532.034,67	67.096,44	1.599.131,11	20.000.000,00

DEKRET

Nr. 9763, datë 12.10.2016

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE, BASHKIA KOLONJË, QARKU KORÇË

Në mbështetje të nenit 92, germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10, paragrafi 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Caktimin e datës 20 nëntor 2016, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Kolonjë, qarku Korçë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

**URDHËR****Nr. 6811, datë 13.10.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, pikës 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 11, pikës 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë nga data 13.10.2016, ora 13:00, deri në datën 15.10.2016, ora 10:00, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Arben Isaraj.

2. Ngarkohet zëvendësministri, z. Arben Isaraj, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË**Ylli Manjani**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 114 lekë